REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02-180/05/23**
**Datë: 23.05.2023 .**

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

# FTESË

**Për:** Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
**Nga:** **Shpejtim Gacaferi** - kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
**Lënda:** Mbledhja e pestë (5) - e rregullt 2023 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
**Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;**
**Data:** **31.05.2023**, ora **10 00**.

## Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesavenë mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - Vendimit për formimin e Grupit te Grave të Komunës së Junikut;
4. Informatë rreth Qarkores Buxhetore 2024/01 ;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së qytetarit Sami jasiqi për ndrrimin e destinimit nga destinimi i planifikuar " Palester Sportive - stadion " , prodhimtari ( industri e lehtë dhe ushqimore ) në **Lagje banimi individual me etazhitet B+P+1E dhe Afarizem sipas projektit ideor;**
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

| | |
|---|---|
| REFERENC-Ë: | Nr. 06-350-4324 |
| DATË: | 22.05.2023 |
| PËR/ZA/TO: | z.Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit të Komunës |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | z.Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës së Junikut |
| NGA/OD/FROM: | z.Zenun Shala – Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë për propozim **Vendim** |

Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040), neni 42, pika j) të Statutit të Komunës së Junikut, (Nr. 001/3127, të datës: 29.9.2010), neni 38 paragrafi 1) i Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës Junikut, neni 58 pika k) si dhe bazuar edhe në kërkesën e z. Sami Jasiqi drejtuar drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis ju bëjmë këtë:

## KËRKESË

Që të vendosni në rendin e ditës në mbledhjen e radhës së Kuvendit të Komunës kërkesën për:

**Ndërrimin e destinimit të ndërtimit për parcelat 00489-9, dhe 00489-15.**

**Nga:** Prodhimtari ( Industri e lehtë dhe ushqimore), respektivisht,
Hapësirë e gjelbërt dhe hapësirë për ambiente sportive (stadium, Pallat sporti, palestër).
**Në: banim i ulët (lagje banimi me shtëpi të banimit individual, me etazhitet B+P+1), dhe Afarizëm**

P.S. Propozim – Vendimi për Ndërrimin e destinimit të ndërtimit vie si kërkesë e investuesit drejtuar institucioneve kompetente bazuar në kërkesat dhe nevojat e komunitetit për zgjidhje të çështjes së banimit.

Me respekt!

Në bazë të neneve 11; 12 paragrafi 12.2 pika d), nenit 17, pika a), b), c), dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040); neni 12 paragrafët 2 dhe 3 të U. A. MMPH - nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor komunal; nenit 10 paragrafi a) dhe b) si dhe nenit 22, pargrafi 22.1, pika 4) i Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis propozon ketë:

**Propozim VENDIM**
**Për**

**Ndërrimin e destinimit të ndërtimit për parcelat 00489-9, dhe 00489-15.**

I. Me këtë propozim - Vendim parcelat numër: P-73105038-00489-9 dhe P-73105038-00489-15, Zona kadastrale Junik, **nga destinimi i ndërtimit** "Prodhimtari ( Industri e lehtë dhe ushqimore)", respektivisht "Hapësirë e gjelbër dhe hapësirë për ambiente sportive (stadium, Pallat sporti, palestër)", **Në** banim i ulët (lagje banimi me shtëpi të banimit individual, me etazhitet B+P+1), dhe Afarizëm (sipas projektit ideor të prezantuar).

II. Objekt i ndërrimit të destinimit të ndërtimit të këtij propozim vendimi janë pronat e paluajtshme si: P-73105038-00489-9 me sipërfaqe prej 26898 m², respektivisht P-73105038-00489-15 me sipërfaqe 40609 m², ku të njëjtat evidentohen në emër të Sami (Ahmet) Jasiqi sipas Ekstrakt nga Certifikata me nr.6-942/3-4323. Të datës 17.05.2023.

III. Kompensimi për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore do të paguhet në procedurë administrative me rastin e aplikimit për Kushte ndërtimi sipas kritereve të parapara me nenin 14 paragrafi 14.2 pika a) të U.A. për ndërrimin e destinimit të Tokës Bujqësore ( U.A.Nr. 41/2006)

IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis e komunës së Junikut.

## Arsyetim

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis (DUKM), pas pranimit të kërkesës së datës 19.05.2023 me Nr. Protokoli 06-1350-4393 të parashtruar nga z. Sami Jasiqi i cili përmes kësaj kërkese iu drejtohet institucioneve kompetente për realizimin e kërkesës së tij pasi që destinimi i ndërtimit sipas planeve ( PZHU dhe PZHK) nuk përputhet me destinim e ndërtimit të investitorit. Kërkesa e investuesit është që Destinimi i ndërtimit të jetë banim i ulët (lagje banimi me shtëpi të banimit individual, me etazhitet B+P+1), dhe afarizëm (sipas projektit ideor të prezantuar).
Sipas, Planit Zhvillimor Komunal, respektivisht Plani Zhvillimor Urban, parcelat P-73105038-00489-9 dhe P-73105038-00489-15, Zona kadastrale Junik janë brenda kufirit të zonës Urbane me destinim ndërtimi:

- Në parcelën P- 73105038-00489-9 Prodhimtari ( Industri e lehtë dhe ushqimore), ndërsa
- Në parcelën P- 73105038-00489-15 Hapësirë e gjelbër dhe hapësirë për ambiente sportive (stadium, Pallat sporti, palestër).

Këtë përshkrim të gjendjes faktike dhe të planifikuar e argumentojmë me hartat e shkëputura nga PZHU e që janë hartat:

- AO4 e cila hartë pasqyron analizën e gjendjes ekzistuese, ku parcelat në fjalë identifikohen si hapësira djerrë, dhe
- PO1 në të cilën hartë prezantohet gjendja e planifikuar.






Vlen të theksohet se kërkesa për ndërrim destinimi të ndërtimit vie si rezultat i mungesës së interesimit për realizim të aktiviteteve të planifikuara me PZHU të miratuar në Kuvendin e Komunës së Junikut në vitin 2009. Dhe si pasojë e shtimit të interesimit për zgjidhjen e nevojës së banimit si çështje bazike e ekzistencës së familjes.
Po ashtu fakt me rëndësi është se në kohën e hartimit të planeve hapësinorë për Junikun konkretisht PZHU dhe PZHK parcelat në fjalë ishin prona nën menaxhim të AKP-së dhe synohej përmes rrugëve ligjore të shndërroheshin në hapësira komunale gjë që nuk ndodhi dhe përmes procesit të privatizimit pronat u privatizuan.

Po ashtu bazuar në LIGJI NR. 04/L – 110 PËR NDËRTIM neni 18 paragrafi 1. **Nëse nuk ekziston plani rregullativ urban, aplikuesi i propozon organit kompetent kushtet ndërtimore që dalin mbi bazën e diametrit prej pesëdhjetë (50) metrave nga vijat kufizuese të parcelës tokësore për të cilën aplikuesi ka kërkuar të ndërtoj objektin e tij ndërtimor.** Nga kjo mund të themi se parcelat në fjalë përmbushin rregullimin hapësinor të planifikuar pasi që këto parcela gjenden në mes të dy lagjeve aktuale si: lagja Agim Ramadani dhe kompleksi i shtëpive individual të banimit "Oda Rezidencë".

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance
Prishtinë - Priština - Prishtina

01/4/40 | 1026/2005
9 | 15 05 2023
PRISHTINË

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
***Qeveria–Vlada-Government***
*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve / Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfera / Ministry of Finance, Labour and Transfers*

*Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister*

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 15.05.2023 |
| PËR/ZA/TO: | Ministrat, Kryetarët e Komunave, Kryeshefat e Agjensioneve, Udhëheqësit e Organizatave buxhetore, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar, |
| NGA/OD/FROM: | Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Qarkorja Buxhetore 2024/01 |

Të nderuar,

Më lejoni t'ju falënderoj për kontributin e juaj në hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2024-2026, që paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2024.

Në vijim mund të gjeni Qarkoren Buxhetore 2024/01, e cila ofron kufijtë fillestar buxhetor për secilën Organizatë Buxhetore në nivel qendror dhe kufijtë buxhetor të nivelit komunal për vitin 2024-2026. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve mbetet në dispozicion të juaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë procesit të hartimit të Projektligjit të ndarjeve buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024.

Me respekt!

Hekuran Murati
Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

## 3. Parashikimet për implementimin e buxhetit 2023

Para prezantimit të kërkesave buxhetore për vitin 2024, organizatat buxhetore duhet t'i prezantojnë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve një parashikim të realizimit deri në fund vit të buxhetit të vitit 2023 në nivel të programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve individuale. Po ashtu, organizatat buxhetore duhet të identifikojnë dhe të njoftojnë Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për nën shpenzimet eventuale në buxhetin aktual, para parashtrimit të kërkesës buxhetore për vitin 2024, dhe vlerësimeve për 2025-2026.

## 4. Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për 2024-2026

Procesi buxhetor për vitet 2024-2026 ka për qëllim ndërlidhjen e planeve dhe politikave buxhetore me prioritetet e Qeverisë. Në nivel sektorial, kjo ndërlidhje është realizuar në prioritizimin e sektorëve buxhetor në KASH 2024-2026. Përmes kësaj qarkoreje, kërkohet që organizatat buxhetore të konkretizojnë kërkesat e prezantuara në KASH, duke detajuar kështu përgatitjen e buxhetit në nivel të programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve specifike.

Kërkesat për shpenzime të reja duhet të prezantohen vetëm në bazë të hapësirës së lirë fiskale dhe nëse të njëjtat janë përfshirë në KASH 2024-2026. Gjatë procesit buxhetor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të sigurohet se totali i shpenzimeve për të gjitha organizatat brenda një sektori e përcjell shumën e paraparë me KASH 2024-2026 për këtë sektor.

Organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre t'u japin prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioriteteve të Qeverisë dhe dokumenteve strategjike. Projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake dhe që kanë obligime kontraktuale, duke përfshirë obligimet e shpronësimit lidhur me ato projekte;
- Zotimet e Qeverisë për Planin e Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe programin – Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA);
- Legjislacioni i ri apo ndryshim plotësimi i atij ekzistues dhe
- Të përfshijnë brenda ndarjeve buxhetore obligimet për financim të jashtëm të projekteve individuale.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale;
- Prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2024 dhe projeksionet për vitet 2025-2026 dhe
- Gjatë procesit buxhetor vëmendje e shtuar duhet t'i jepet nga OB-të në nivel qendror dhe lokal zbatimit të çështjeve si në vijim:
    - OB-të të mos propozojnë aktivitete apo projekte të reja pa i dhënë prioritet buxhetimit të obligimeve për aktivitetet/projektet kapitale;

**Shpenzimet rrjedhëse:** organizatat buxhetore duhet të bëjnë kërkesat e tyre përbrenda kufizimeve buxhetore. Është thelbësore që të gjitha organizatat buxhetore t'u përmbahen kufijve të dhënë në Shtojcat e bashkangjitura.

**Punësimi:** Nuk do të ketë rritje të punësimit në sektorin publik përveç kur ka një vendim të qartë për domosdoshmërinë e punësimeve të reja dhe kur është siguruar buxheti.

***Pagat dhe shtesat: Ligji pagave për sektorin publik është aprovuar ne Kuvendin e Kosovës dhe i publikuar në gazetën zyrtare me dt.05.01.2023 dhe si i tillë ka filluar aplikimin nga muaji Shkurt i vitit 2023.***
Për kalkulimin e pagave për vitin 2024 është marrë për bazë për përllogaritje muaji mars 2023 dhe për punëtorët aktual është llogaritur shumëzuar me 12 muaj. Ndërsa për punëtorët e papunësuar është përllogaritur paga mesatare dhe është buxhetuar vetëm 30%, brenda kufizimeve buxhetore.
Kjo kategori e shpenzimeve mund t'i nënshtrohet ndryshimit për organizata buxhetore varësisht prej zbatimit te procesit te ekuivalencës.
***Mallra dhe shërbime***: Organizatave buxhetore do t'i mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë burimet brenda skenarëve bazë të tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit të lartë të Qeverisë.

***Shpenzimet komunale:*** pritet të ketë pjesëmarrje përafërsisht të njëjtë krahasuar me vitin 2023.
***Subvencionet dhe transferet:*** Subvencionet dhe transferet, pritet të rriten mesatarisht me rreth 3.7%. Do të vazhdohet me ndarjen e mjeteve për zbatimin e skemave sociale dhe pensionale përfshirë këtu edhe rritjen natyrale të skemave pensionale, subvencionimet në bujqësi si dhe politikat e reja tani më të aprovuara në Qeveri.

***Shpenzimet kapitale:*** përbëjnë një pjesë konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe në periudhën afatmesme pritet që të përfaqësojnë rreth 23.9% të shpenzimeve totale. Gjatë kësaj periudhe, pritet implementimi i projekteve kapitale bazuar në një listë prioritetesh që përmban projekte me ndikim në përmirësimin e rrjetit të transportit, përmirësimin e rrjetit të energjisë elektrike dhe përmirësimin e kushteve në arsim, sistemin social dhe atë shëndetësor. Pjesa më e madhe e investimeve kapitale gjatë periudhës së ardhshme afatmesme pritet të jetë nga financimi i buxhetit të rregullt, mirëpo një numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshëm planifikohet të financohet nga huazimi i jashtëm përmes klauzolës së investimeve.

Për organizatat buxhetore të cilat konkurrojnë për fonde të huamarrjes (nga deficiti buxhetor prej 2% - përmes fondit 04) dhe nga klauzola e investimeve – përmes fondit 06 (aplikimi për fondet nga klauzola bëhet vetëm për projekte kapitale), është gjithashtu e nevojshme që projektet të plotësojnë kriteret e sipërpërmendura duke përfshirë analizën e shpenzimeve rrjedhëse para, gjatë dhe pas përfundimit të projektit të cilat duhet të jenë në kuadër të projeksioneve të organizatës buxhetore.

## 5. Programi për investime publike (PIP)

Planifikimi i buxhetit për investime kapitale bëhet përmes sistemit të PIP-it. Është e rëndësishme që prioritetet strategjike të Qeverisë, ashtu si janë paraqitur në "Deklaratën e

## 9. Kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore të nivelit qendror për 2024-2026

Organizatat Buxhetore të nivelit qendror duhet të marrin parasysh kufijtë buxhetore të dhënë në tabelën në vijim gjatë përgatitjes së buxhetit të tyre për vitin 2024 dhe për dy vitet në vijim. Ju lutem të keni parasysh se këta kufij buxhetor mund të ndryshojnë varësisht nga lëvizjet fiskale apo vendimet e Qeverisë të cilat do të pasqyrohen përmes Qarkoreve Buxhetore pasuese si dhe kualitetit të kërkesave buxhetore. Projektet kapitale të filluara nga vitet e kaluara, të cilat kanë krijuar obligime kontraktuale duhet të përfshihen brenda buxhetit për vitet 2024-2026.

Më poshtë në Tabelën 1 janë kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore qendrore për 2024-2026.

## 10. Fazat e procesit buxhetor për vitin 2024 për nivelin qendror

Pjesa në vijim prezanton kalendarin kohor të buxhetit, hapat dhe veprimet gjatë procesit buxhetor për vitin 2024.

• 29 Prill – aprovimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2024-2026 nga Qeveria dhe dorëzimi i KASH-it në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

• 15 Maj - Lëshimi i Qarkores së parë buxhetore 2024/01. Kjo qarkore përmban udhëzimet për procesin buxhetor, kufijtë buxhetor dhe kalendarin buxhetor.

• 26 Qershor- Organizatat buxhetore të dorëzojnë në MFPT kërkesat buxhetore sipas dokumentacionit përkatës, sipas programeve dhe kategorive të shpenzimeve. Kërkesat buxhetore duhet të jenë plotësisht të arsyetuara përmes përdorimit të sistemit të SZHMB-se dhe PIP-it.

• 26 Qershor- Departamenti i Makroekonomisë paraqet kornizën e re makro-fiskale.

• 11 Korrik - Qarkorja buxhetore 2024/02 do të lëshohet sipas nevojës dhe do të adresoj vetëm çështjet specifike të reja të cilat kanë rezultuar pas lëshimit të Qarkores së parë buxhetore.

• 25 Korrik- Nëse kërkohen informata shtesë sipas Qarkores së dytë buxhetore atëherë këto informata duhet të dorëzohen nga Organizatat buxhetore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamentin e Buxhetit deri në këtë datë.

• 21 Gusht – 29 Gusht - Dëgjimet buxhetore (pas pranimit të materialeve nga organizatat buxhetore). Pjesëmarrës në dëgjime do të jenë zyrtarët të organizatave buxhetore, stafi i MFPT, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Buxhet, Punë dhe Transfere. Orari i dëgjimeve buxhetore do t'i bashkëngjitet Qarkores buxhetore 2024/02. Nëse është e mundur në këto dëgjime, do të shikohet mundësia e arritjes së marrëveshjes për shumat totale të buxhetit të organizatës suaj për vitin 2024.

• 12 Shtator, Departamenti i Makroekonomisë paraqet vlerësimet e fundit për indikatorët makro-ekonomik, posaçërisht indikatorët që lidhen me procesin buxhetor 2024-2026.

• 18 Shtator – 22 Shtator, konsultime në Qeveri për caktimin e kufijve final buxhetor.

• 26 Shtator, nxjerrja e Qarkores së tretë buxhetore me kufijtë final buxhetor, të cilët mund të ndryshojnë nga qarkorja paraprake.

• 28 Shtator-3 Tetor Ankesat nga Organizatat Buxhetore.

• 9 Tetor – 11 Tetor, Takimet e Qeverise për t'i shqyrtuar ankesat e organizatave buxhetore.

• 16 Tetor, Drafti i parë i buxhetit në MFT dhe dërgimi i këtij drafti në Qeveri.

• 17 Tetor –24 Tetor - miratimi final i Draft Buxhetit në Qeveri.

• 27 Tetor - Dorëzimi i Draft Buxhetit 2023 në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kërkesa për buxhet nga organizata buxhetore të nivelit qendror duhet të përfshijë;

• Një tabelë me parashikimet deri në fund vit të implementimit të buxhetit 2023, në nivel programi dhe nën-programi, si dhe komentet përcjellëse për nën-ekzekutimin apo mbi-ekzekutim nga ndarjet e buxhetit 2023

• Tabelat 3.1, 3.1 A, 3.1 B si dhe Formularët e PCF-ve të shtypura nga sistemi i SZHMB-së,

• Tabelat 3.2, 3.2 B dhe Formularët e shtypur nga Sistemi PIP,

• Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor,

• Tabela e e Indikatoreve të performancës.

• Kërkesa buxhetore duhet të jetë e konsoliduar në nivel te ëorganizatës buxhetore duke përfshirë agjensionet ekzekutive.

• Letër kërkesa (shkresa përcjellëse) e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm apo Kryeshefi i agjencise me të gjitha materialet buxhetore.

• Përshkrimi i kërkesës në formë narrative, ku duhet të paraqiten këto të dhëna:

□ Të arriturat deri më tani me fokus të veçantë në realizimin e objektivave të parapara në dokumentet strategjike.;

# Niveli komunal

## Hyrje

Me këtë dokument përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2024 dhe orientimet për vitet 2025-2026, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, ky dokument përcakton nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2024 si dhe parashikimin afatmesëm 2025-2026.

Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2024, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe
- Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve dhe burimeve të financimit për vitin 2024 dhe projeksionet për vitet 2025-2026,

Komunat janë të obliguara të përgatisin Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2024-2026, dhe të aprovojnë në Kuvendin Komunal deri me datë 30.06.2023 si dokument strategjik komunal, i cili dokument pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve.
Projektet kapitale shumëvjeçare duhet të raportohen në sistemin e Projekteve të Investimeve Publike (PIP) bazuar në performancë. Si rrjedhojë, nga komunat kërkohet të hartojnë strategjinë kornizë bazuar në synimet dhe objektivat të orientuara në rezultate.

### 1. Burimet e Financimit Komunal për vitin 2024-2026

#### *1.1 Granti i Përgjithshëm*

Bazuar në Tabelën 1, të paraqitur në vijim, të përgatitur nga Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 284.68 milion euro,

Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përjashtuar: mbështetjen buxhetore dhe grantet, grantet e përcaktuara të donatorëve, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale.

Siç paraqitet në tabelën në vijim, bazuar në vlerësimet të Departamentit të Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar, të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2024 pritet të jenë 2,985.32 mil. euro. Nga kjo shumë, zbriten ato të hyra siç specifikohet në nenin 24 të LFPL dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 284.68 milion euro.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kritere:

a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2022/2023;
b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 22/2013 të MASHTI-it);
c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;
i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm
j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;
l) Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
m) Koordinatorët e cilësisë;
n) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
o) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;
p) Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta;
q) Praktika profesionale;
r) Kosto e pagesës së procedurave për validim dhe akreditim për shkollat e mesme të larta profesionale (8 Shkolla);
s) Këshilltarë të karrierës me bazë në shkollë klasa 6 deri 9;
t) Specialist të IT-së.

Sipas MASHTI-të është raportuar numri për 9,859 nxënës më pak në arsim para universitar krahasuar me vitin paraprak.

Numri i synuar për reduktim të 485 pozitave të lira (Tabela 5) ka të bëjë me mos plotësimin e tyre duke pas parasysh faktin që këto pozita jen mbi formulën e financimit për arsimin parauniversitar.
Po ashtu në rastet kur numri aktual është mbi numrin e lejuar sipas formulës së financimit, me rastin e pensionimit të stafit aktual nuk do të ketë punësim të ri me qellim të arritjes së synimit për respektimin e numrit sipas formulës se financimit.

Tabela 7: Të dhënat statistikore për Shëndetësinë primare për vitin 2024-2026

Popullsia, Standardet për mjek dhe Infermier dhe Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor

| Nr. | Komuna | Popullsia | Demografia – Gjinia – M | Demografia – Gjinia – F | Femra të moshës riprodhuese 15-49 vjeç | Mosha – Numri i fëmijëve 0-14 vjeç | Mosha – Numri i personave të moshuar mbi 65 vjeç | Numri i personave me nevoja të veçanta | Standardet për mjek dhe infermier – Standardet 1 MP/2000 banorë | Standardet 01 Stomatolog 5000 banorë | Standardet 01 Farmacist në QKMF | Standardet 01 Biokimist në QKMF | Gjithsej Mjek | Infermier Familjarë | Infermier (për mjek specialist, stomatolog, laborator etj) | Gjithsej (mjek dhe infermier dhe farmacist) | Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor – Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) | Qendër e Mjekësisë Familjare (QMF) 10,000 banorë | Ambulanca e Mjekësisë Familjare (AMF) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Deçan | 40,079 | 20,123 | 19,896 | 10,941 | 10,471 | 7,968 | 50 | 20 | 8 | 1 | 1 | 30 | 40 | 17 | 97 | 1 | 3 | 6 |
| 2 | Dragash | 33,997 | 17,035 | 16,962 | 8,748 | 8,659 | 3,139 | 202 | 17 | 7 | 1 | 1 | 26 | 34 | 49 | 169 | 1 | 5 | 8 |
| 3 | Ferizaj | 108,610 | 54,841 | 53,769 | 23,736 | 31,566 | 6,567 | 1,241 | 56 | 24 | 1 | 1 | 80 | 118 | 74 | 272 | 1 | 8 | 5 |
| 4 | Fushë Kosovë | 34,827 | 17,621 | 17,206 | 9,299 | 9,906 | 2,149 | 293 | 17 | 7 | 1 | 1 | 26 | 34 | 48 | 108 | 1 | 5 | 6 |
| 5 | Gjakovë | 94,556 | 47,226 | 47,330 | 26,654 | 26,423 | 12,129 | 1,130 | 48 | 19 | 1 | 1 | 69 | 84 | 54 | 217 | 1 | 9 | 15 |
| 6 | Gjilan | 90,178 | 45,354 | 44,824 | 19,771 | 29,288 | 9,358 | 1,160 | 45 | 18 | 1 | 1 | 65 | 90 | 52 | 207 | 1 | 7 | 10 |
| 7 | Gllogovc | 58,531 | 29,733 | 28,798 | 18,260 | 14,317 | 5,213 | 211 | 30 | 12 | 1 | 1 | 44 | 60 | 71 | 175 | 1 | 5 | 7 |
| 8 | Hani i Elezit | 9,403 | 4,836 | 4,567 | 1,824 | 2,778 | 500 | 73 | 5 | 2 | 1 | 1 | 9 | 10 | 7 | 26 | 1 | 0 | 1 |
| 9 | Istog | 35,285 | 19,677 | 15,608 | 10,607 | 10,235 | 3,093 | 464 | 20 | 8 | 1 | 1 | 30 | 40 | 41 | 111 | 1 | 4 | 8 |
| 10 | Junik | 6,084 | 2,995 | 3,089 | 1,595 | 1,681 | 420 | 15 | 3 | 1 | 1 | 1 | 6 | 6 | 8 | 20 | 1 | 0 | 0 |
| 11 | Kaçanik | 33,409 | 16,970 | 16,439 | 9,854 | 9,683 | 3,940 | 200 | 17 | 7 | 1 | 1 | 26 | 34 | 59 | 119 | 1 | 4 | 8 |
| 12 | Kamenicë | 36,085 | 18,600 | 17,485 | 16,505 | 8,900 | 2,143 | 360 | 18 | 7 | 1 | 1 | 27 | 36 | 57 | 120 | 1 | 3 | 17 |
| 13 | Klinë | 38,496 | 19,293 | 19,203 | 10,272 | 11,398 | 2,606 | 200 | 19 | 8 | 1 | 1 | 29 | 18 | 13 | 82 | 1 | 3 | 9 |
| 14 | Leposaviq | 13,773 | 6,969 | 6,804 | 3,443 | 2,754 | 968 | | 7 | 3 | 1 | 1 | 12 | 14 | 15 | 41 | 1 | 0 | 1 |
| 15 | Lipjan | 57,605 | 29,325 | 28,280 | 15,355 | 17,461 | 7,043 | 705 | 29 | 12 | 1 | 1 | 43 | 58 | 65 | 166 | 1 | 4 | 7 |
| 16 | Malishevë | 54,614 | 25,901 | 28,713 | 16,930 | 20,758 | 3,622 | 690 | 35 | 14 | 1 | 1 | 51 | 70 | 29 | 150 | 1 | 6 | 7 |
| 17 | Mamushë | 5,508 | 2,672 | 2,836 | 1,543 | 2,570 | 737 | 15 | 3 | 1 | 1 | 1 | 6 | 6 | 3 | 15 | 1 | 0 | 0 |
| 18 | Mitrovicë | 71,909 | 36,275 | 35,634 | 18,634 | 20,351 | 5,074 | 1,200 | 36 | 14 | 1 | 1 | 52 | 72 | 76 | 200 | 1 | 11 | 10 |
| 19 | Novobërdë | 6,730 | 3,466 | 3,264 | 1,736 | 1,643 | 792 | 41 | 3 | 1 | 1 | 1 | 6 | 7 | 8 | 21 | 1 | 3 | 0 |
| 20 | Obiliq | 21,549 | 10,885 | 10,664 | 5,636 | 6,419 | 1,239 | 337 | 11 | 4 | 1 | 1 | 17 | 22 | 34 | 73 | 1 | 3 | 4 |
| 21 | Pejë | 96,451 | 50,466 | 45,985 | 21,930 | 33,320 | 10,783 | 1,047 | 57 | 23 | 1 | 1 | 82 | 116 | 105 | 303 | 1 | 5 | 14 |
| 22 | Podujevë | 88,499 | 44,955 | 43,544 | 23,385 | 27,063 | 5,122 | 879 | 44 | 18 | 1 | 1 | 64 | 88 | 68 | 220 | 1 | 3 | 18 |
| 23 | Prishtinë | 188,897 | 99,361 | 89,536 | 54,300 | 51,403 | 25,008 | 2,149 | 99 | 40 | 1 | 1 | 141 | 199 | 156 | 495 | 1 | 15 | 15 |
| 24 | Prizren | 177,781 | 89,176 | 88,605 | 48,677 | 49,199 | 12,502 | 1,602 | 89 | 36 | 1 | 1 | 127 | 179 | 116 | 421 | 1 | 15 | 27 |
| 25 | Rahovec | 56,208 | 28,512 | 27,696 | 15,393 | 16,081 | 3,352 | 377 | 28 | 11 | 1 | 1 | 41 | 56 | 77 | 174 | 1 | 7 | 7 |
| 26 | Shtërpcë | 6,949 | 3,554 | 3,395 | 1,707 | 1,777 | 608 | 23 | 3 | 1 | 1 | 1 | 6 | 7 | 8 | 21 | 1 | 0 | 2 |
| 27 | Shtime | 27,328 | 13,850 | 13,478 | 9,874 | 7,877 | 2,200 | 38 | 14 | 5 | 1 | 1 | 21 | 28 | 30 | 69 | 1 | 4 | 0 |
| 28 | Skenderaj | 50,858 | 25,646 | 25,212 | 16,515 | 14,925 | 4,150 | 3,758 | 26 | 10 | 2 | 1 | 38 | 52 | 50 | 140 | 1 | 5 | 8 |
| 29 | Suharekë | 59,772 | 29,478 | 30,294 | 16,413 | 17,409 | 4,309 | 638 | 30 | 12 | 1 | 1 | 44 | 60 | 38 | 142 | 1 | 6 | 11 |
| 30 | Viti | 46,987 | 23,686 | 23,301 | 12,310 | 14,167 | 3,028 | 499 | 23 | 9 | 1 | 1 | 34 | 46 | 25 | 105 | 1 | 4 | 7 |
| 31 | Vushtrri | 69,870 | 36,004 | 33,866 | 19,146 | 19,634 | 4,508 | 800 | 35 | 14 | 1 | 1 | 51 | 70 | 55 | 176 | 1 | 10 | 9 |
| 32 | Zubin Potok | 6,616 | 3,408 | 3,208 | 1,456 | 1,588 | 476 | 98 | 3 | 1 | 1 | 1 | 6 | 2 | - | 13 | 1 | 0 | 0 |
| 33 | Zveçan | 7,481 | 3,661 | 3,820 | 95 | 157 | 45 | 1 | 4 | 1 | 1 | 1 | 7 | 2 | | 14 | 1 | 1 | 0 |
| 34 | Graçanicë | 10,675 | 5,428 | 5,247 | 2,463 | 2,661 | 993 | 81 | 5 | 2 | 1 | 1 | 9 | 11 | | 20 | 1 | 3 | 11 |
| 35 | Kllokot | 2,556 | 1,416 | 1,140 | 688 | 870 | 214 | 18 | 1 | 1 | 1 | 1 | 4 | 3 | 7 | 14 | 1 | 0 | 1 |
| 36 | Mitrovicë Veriore | 12,326 | 6,272 | 6,054 | 2,688 | 2,931 | 879 | 82 | 6 | 2 | 1 | 1 | 10 | 12 | 10 | 37 | 1 | 0 | 0 |
| 37 | Partesh | 1,787 | 922 | 865 | 477 | 340 | 202 | | 1 | 1 | 1 | 1 | 4 | 2 | | 6 | 1 | 0 | 2 |
| 38 | Ranillug | 3,866 | 1,969 | 1,897 | 1,053 | 399 | 259 | - | - | | 1 | 1 | 2 | 4 | | 6 | 1 | 0 | 0 |
| Total | | 1,780,021 | 897,561 | 882,460 | 495,030 | 488,245 | 150,187 | 20,494 | 905 | 364 | 38 | 38 | 1,345 | 1,828 | 1,527 | 4,700 | 38 | 162 | 261 |

### *1.5 Financimi për Shëndetësi sekondare*

Financimi për shëndetësinë sekondare për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 2,603,077 euro sipas propozimit nga MSH dhe projeksioneve të KASH për tri komunat minoritare, si vijon:

- Komuna e Shtërpcës, në shumë prej 522,371 euro,
- Komuna e Mitrovicës së veriut, në shumë prej 989,935 euro, dhe
- Komuna e Graçanicës, në shumë prej 1,090,771 euro.

### *1.6 Financimi për Shërbimet rezidenciale*

Financimi i shërbimeve rezidenciale për shtëpitë e komunitetit për personat e moshuar dhe shtëpitë e komunitetit për personat me aftësi të kufizuara për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 3.5 milion euro.

Tabela 9: Financimi për shërbime rezidenciale për vitin 2024-2026

| Nr | Komunat | Paga dhe Shtesa | Mallra dhe Shërbime | Shpenzime Komunale | Shpenzime Kapitale | Gjithsej 2024 | Gjithsej 2025 | Gjithsej 2026 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Financimi për shtëpitë e komunitetit për persona të moshuar (SHKPM) | | | | | | | | |
| 1 | Skenderaj | 95,981 | 75,000 | 10,000 | 15,000 | 200,000 | 200,000 | 200,000 |
| 2 | Graçanicë | 74,484 | 75,000 | 10,000 | 15,000 | 200,000 | 200,000 | 200,000 |
| 3 | Istog | 95,318 | 75,000 | 10,000 | 15,000 | 200,000 | 200,000 | 200,000 |
| 4 | Novobërdë | 73,297 | 75,000 | 10,000 | 15,000 | 200,000 | 200,000 | 200,000 |
| 5 | Prizren | 98,283 | 75,000 | 10,000 | 15,000 | 200,000 | 200,000 | 200,000 |
| 6 | Prishtinë | 434,127 | 225,000 | 50,000 | 100,000 | 900,000 | 1,000,000 | 1,000,000 |
| | **Gjithsej SHKPM** | **871,690** | **600,000** | **100,000** | **175,000** | **1,900,000** | **2,000,000** | **2,000,000** |
| Financimi për shtëpitë e komunitetit për personat me aftësi të kufizuar (SHKPAK) | | | | | | | | |
| 1 | Graçanicë | 53,827 | 75,000 | 10,000 | 15,000 | 200,000 | 200,000 | 220,000 |
| 2 | Deçan | 88,318 | 75,000 | 10,000 | 15,000 | 200,000 | 200,000 | 200,000 |
| 3 | Ferizaj | 79,096 | 75,000 | 10,000 | 15,000 | 200,000 | 200,000 | 220,000 |
| 4 | Kamenicë | 77,272 | 75,000 | 10,000 | 35,000 | 220,000 | 200,000 | 200,000 |
| 5 | Vushtrri | 86,434 | 75,000 | 10,000 | 15,000 | 200,000 | 200,000 | 200,000 |
| 6 | Shtime | 78,712 | 75,000 | 10,000 | 15,000 | 200,000 | 200,000 | 230,000 |
| 7 | Lipjan | 77,066 | 75,000 | 10,000 | 15,000 | 200,000 | 200,000 | 250,000 |
| 8 | Prizren | 79,200 | 75,000 | 10,000 | 15,000 | 200,000 | 200,000 | 200,000 |
| | **Gjithsej SHKPAK** | **619,925** | **600,000** | **80,000** | **140,000** | **1,620,000** | **1,600,000** | **1,700,000** |
| | **Gjithsej SHKPAK, SHKPM** | **1,491,615** | **1,200,000** | **180,000** | **315,000** | **3,520,000** | **3,600,000** | **3,700,000** |

Financimi i kërkuar shtesë si në tabelën e më poshtme (Tabela 10) nga Ministria e linjës për hapjen e shtëpive të reja për personat e moshuar, për personat me aftësi të kufizuara dhe shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve në shume prej 4.5 milion euro do të financohet nga Granti i përgjithshëm, si dhe stafi shtesë do të adresohet përmes rregullimeve të brendshme të komunës (pozitat e lira), pra nuk do të ketë aprovim të pozitave shtesë.

### *1.7 Financimi për Qendrën historike të Prizrenit, Qendrën kulturore të fshatit Zym dhe Keshillin e Hoçës së madhe*

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, Ligjit Nr.04/L-196 për Qendrën Kulturore Historike të Fshatit Zym dhe Ligjit Nr. 04/L-62 për Fshatin Hoçë e Madhe, me planifikimin e buxhetit për vitin 2024 ndahen mjete financiare në shumë prej 80,603 euro, për dy komunat si vijon:

- Komuna e Prizrenit, në shumë prej 51,532 euro, dhe
- Komuna e Rahovecit, në shumë prej 29,071 euro.

### *1.8 Financimi për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit*

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-044 për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, neni 9 Obiliqi përfiton nga inkasimi i rentës minerale nga institucioni përkatës, 20% e vlerës së kësaj rente rialokohet nga Buxheti Qendror për Buxhetin Komunal të Komunës së Obiliqit, e dedikuar në mënyrë specifike për investime në zhvillimin e komunitetit në lokacionin ku ndodhet njësia biznesore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, infrastrukturës, sportit, shëndetësisë dhe arsimit.
Për vitin 2024 Komuna e Obiliqit bazuar në planifikimin e inkasimit të rentës minerale përfiton financim shtesë prej 5,000,000 euro, për vitin 2025 përfiton shumen prej 5,000,000 euro dhe për vitin 2026 përfiton shume prej 5,000,000 euro.

### *1.9 Financimi për Teatrot*

Financimi për Teatrot për vitin 2024 është në shumë prej 1.62 milion si në tabelën e bashkangjitur në vijim.

Tabela 11: Financimi për Teatrot për vitin 2024-2026

| Nr. | Komunat | Paga dhe shtesa | Subvencionet dhe transferet | Gjithsej 2024 | Gjithsej 2025 | Gjithsej 2026 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ferizaj | 206,500 | 37,746 | 244,246 | 244,246 | 244,246 |
| 2 | Podujevë | 119,992 | 30,757 | 150,749 | 150,749 | 150,749 |
| 3 | Prizren | 202,161 | 61,785 | 263,947 | 263,947 | 263,947 |
| 4 | Gjilan | 243,295 | 31,340 | 274,635 | 274,635 | 274,635 |
| 5 | Gjakovë | 233,405 | 32,862 | 266,266 | 266,266 | 266,266 |
| 6 | Mitrovicë | 199,644 | 24,991 | 224,635 | 224,635 | 224,635 |
| 7 | Pejë | 162,093 | 33,520 | 195,613 | 195,613 | 195,613 |
| Gjithsej | | 1,367,091 | 253,000 | 1,620,091 | 1,620,091 | 1,620,091 |

**Shembull:**

Aneksi 1

## Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor

Tabela 1. Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore përkatëse
Emri i Institucionit/Ministrisë/Komunës

| Viti | Numri total i stafit | Numri total i stafit që janë gra | Numri total i stafit që janë burra | Paga dhe mëditje/Shuma për gra | Paga dhe mëditje/Shuma për burra |
|---|---|---|---|---|---|
| 2021 | | | | | |
| 2022 | | | | | |
| 2023 | | | | | |
| Planifikimi për 2024 | | | | | |

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2024- Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore
Emri i Institucionit/Ministrisë/Komunës

| Niveli i pagave | Numri total i stafit në këtë nivel të pagave | Numri i burrave në këtë nivel | Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel | Numri i grave në këtë nivel. | Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel |
|---|---|---|---|---|---|
| 201-400 | | | | | |
| 401-600 | | | | | |
| 600+ | | | | | |

Tabela 3. Numri i përfituesve të subvencioneve apo edhe të shërbimeve ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)

[Emri i Institucionit/Ministrisë/Komunës: Emri i Shërbimit/Subvencionit].

| Viti | Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar | Numri total i përfituesve | Numri i përfitueseve gra | Numri i përfituesve burra | Buxheti për gra | Buxheti për burra |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2021 | | | | | | |
| 2022 | | | | | | |
| 2023 | | | | | | |
| Planifikimi për 2024 | | | | | | |

**Aneksi 2**

## INDIKATORËT E PERFORMANCËS SË PROGRAMIT BUXHETOR

Tabela 5. Treguesit kyçë të performancës që përshkruajnë rezultatet e pritura të organizatës buxhetore për vitet 2024-2026 (shih dy shembujt në tabelën e mëposhtme)

| Prioriteti 1 i Qeverisë - Reduktimi i ekonomisë joformale për 20 % për periudhën 2024-2026 dhe përmirësimi i mjedisit të të bërit biznes | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri i treguesit të produktit dhe njësia matëse | Burimet e financimit | 2023 (N) (i pritur) | 2024 (N+1) (synuar) | 2025 (N+2) (synuar) | 2026 (N+3) (synuar) |
| 1 | 2 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| | 2,750 inspektime | Granti Qeveritar | 600 inspektime | 650 inspektime | 700 inspektime | 800 inspektime |
| | 1,200 Fushata vetëdijësuese | Granti Qeveritar | 300 fushata | 300 fushata | 300 fushata | 300 fushata |

| Rezultati, rritja e përfshirjes e fëmijëve në edukimin e hershem para fillor 0-6 vjeç për 30 % për vitet 2024-2026 | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri i treguesit të produktit dhe njësia matëse | Burimet e financimit | 2023 (N) (i pritur) | 2024 (N+1) (synuar) | 2025 (N+2) (synuar) | 2026 (N+3) (synuar) |
| 1 | 2 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| | 30 çerdhe për fëmijët parashkollor | Grantet Qeveritare | 6 çerdhe për fëmijët parashkollor | 7 çerdhe për fëmijët parashkollor | 8 çerdhe për fëmijët parashkollor | 9 çerdhe për fëmijët parashkollor |
| | 8 çerdhe për fëmijët parashkollor | IPA/BE | 2 çerdhe për fëmijët parashkollor | 2 çerdhe për fëmijët parashkollor | 2 çerdhe për fëmijët parashkollor | 2 çerdhe për fëmijët parashkollor |

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
Zyra Prot. 04-180-4330
Nr. i lig. 1
Data 17/05/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 17.05.2022 |
| PËR/ZA/TO: | z. Shpejtim Gacaferi– Kryesues i Kuvendit Komunal |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | z. Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës |
| NGA/OD/FROM: | znj. Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë për të shtuar në rend dite në mbledhjen e KPF-së dhe të Kuvendit Komunal informatën rreth Qarkores Buxhetore 2024/01 |

I nderuar,

Bazuar në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) nr: 03/L-048 neni 20, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nr: 03/L-040 neni 40 alinea 40.2 pika nën b), si dhe duke u bazuar në Qarkoren Buxhetore 2024/01 për Komunat të nisur nga Ministria e Financave, kërkojmë nga ju që të shtohet në rend dite në mbledhjen e KPF-së dhe të Kuvendit Komunal informata rreth Qarkores Buxhetore 2024/01.

Sqarim:

Kjo kërkesë vjen me vonesë për arsye se edhe ne si Drejtori e Financave nuk e kemi pranuar me kohë informatën dhe materialin rreth Qarkores Buxhetore 2024/01.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 04-180-4358
Nr. i fletë 1
Data 18/05/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 18.05.2023 |
| PËR/ZA/TO: | Kryetarin e Komunës<br>Kryesuesin e Kuvendit<br>Drejtorët e Drejtorive Komunale |
| NGA/OD/FROM: | znj.Vjollca Qestaj - Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | NJOFTIM |

Të nderuar!

Bazuar në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr 03/L-048, neni 60, Ligjin për Vetëqeverisje lokale ( Ligji Nr:03/ L-040) dhe Statutin e Komunës, pas pranimit të Qarkores Buxhetore 2024/01 në formë elektronike nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të datës 15.05.2023, Komuna ka për obligim fillimin e Procedurave të planifikimit të Buxhetit për periudhën 2024-2026 në përputhje me limitet buxhetore të përcaktuara në Qarkore buxhetore e cila bazohet në KASH-in (Korniza Afatmesme e Shpenzimeve) 2024-2026.
Përmes këtij njoftimi keni obligim që të hartoni planifikimet për Programin tuaj përkatës dhe ti dorëzoni në e-mail dhe ne kopje fizike tek drejtoria për Buxhet dhe Financa deri me datë 30.05.2023.
Në formë elektronike do ti keni të bashkangjitura Qarkoren Buxhetore komunale 2024/01 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Qarkoren e brendshme komunale # 2024-01 dhe formularët e nevojshëm për paraqitjen e propozimeve nga ana juaj.

Bashkangjitur në email:

A) Deklarata për misionin dhe performansën sipas Drejtorive/ Programeve
B) Qarkorja Buxhetore nr. 2024/01 për Komuna (MFPT)
C) Qarkorja e brendshme buxhetore komunale #2024/01
D) Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025 (e vitit të kaluar) ku mund të mbështeteni për ndryshimet që planifikoni të bëni për vitet 2024-2026.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

| | |
|---|---|
| | QARKORE E BRENDSHME BUXHETORE KOMUNALE #2024/01 |
| Për: | Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit, Të gjithë Drejtorët e Drejtorive (Programeve Buxhetore) të KK-Junik |
| Nga: | znj. Vjollca Qestaj - Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa |
| Data: | 18.05.2023 |
| Lënda: | **Përgatitja e materialeve buxhetore - Propozim Buxhetit Komunal sipas Drejtorive (Programeve Buxhetore) për periudhën 2024-2026, sipas Qarkores Buxhetore nr. 2024/01 për Komuna.** |

Kjo Qarkore e brendshme komunale #2024/01 do të ju ofroj udhëzime për përgatitjen e Propozim Buxhetit për Drejtoritë komunale, pasiqë na nevojiten informatat për hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore-Komunale 2024/2026.

Me Qarkoren Buxhetore 2024/01 për Komunat dërguar nga Ministria e Financave, Punës dhe transfereve ju njoftojmë për zhvillimin e procesit buxhetor komunal në pajtim me procedurat dhe kalendarin e përcaktuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Komisioni i Grandeve pranë MFPT ka aprovuar grandet qeveritare për financimin komunal në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitet: 2024-2026, si dhe parimet, kriteret dhe formulat e përcaktuara në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, andaj referojuni asaj qarkoreje si dhe KASH-it të miratuar.

1. Kërkojmë nga të gjithë Drejtorët e Drejtorive (Programeve) buxhetore që deri me datë: 30.05.2023, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa të paraqesin Kërkesat e tyre buxhetore për vitet: 2024-2026, konform limiteve të Qarkores Buxhetore nr. 2024/01, për të gjitha kategoritë buxhetore të shpenzimeve siç janë: Paga&Mëditjet, Mallra dhe shërbime, Shpenzimet komunale, Subvencionet dhe Transferet si dhe Shpenzimet kapitale, (Të ndryshohen projektet nëse është nevoja sipas prioriteteve, të shtohen projektet nëse keni plane, duke ju referuar listës së projekteve 2023-2025 të bashkangjitur në email) si dhe Drejtoria që inkason të hyra të paraqes parashikimin e të hyrave vetanake.
2. Po ashtu duhet të paraqitni numrin e punëtorëve të Drejtorisë (Programit) tuaj buxhetor si dhe koeficientet e pagave (aktual) që ekzistojnë me Buxhetin e vitit 2023 duke e shtuar vetëm një vit te përvojës se punës për vitin e ardhshëm, meqenëse nuk ka lëvizje - rritje të numrit të punëtorëve për vitin fiskal 2024.
3. Grandi i Përgjithshëm për Komunën e Junikut për vitin 2024 sipas qarkores buxhetore 2024/01 është parashikuar të jetë 1,103,827.00€ që ka një rritje në vlerë prej 101,704.00€ krahasuar me vitin e kaluar, andaj kërkohet nga ne që ti kemi edhe planifikimet sa më prioritare për shkak të limiteve buxhetore të dërguara nga qeveria.
4. Grandi specifik për Arsim për komunën e Junikut për vitin 2024 sipas qarkores buxhetore 2024/01 është parashikuar të jetë 554,726.00€ që ka një rritje prej 82,200.00€ krahasuar me vitin e kaluar.
5. Grandi specifik për shëndetësi për komunën e Junikut për vitin 2024 sipas qarkores buxhetore 2024/01 është parashikuar të jetë 334,227.00€, që ka një rritje ne vlere prej 89,860.00€ krahasuar me vitin e kaluar.
6. Të hyrat vetanake të parashikuara janë 208,056.00€, që ka një rritje në vlerë prej 48,726.00€ krahasuar me vitin të kaluar.
7. Totali i buxhetit për komunën e Junikut për vitin 2024 sipas qarkores buxhetore 2024/01 është parashikuar të jetë 2,199,836.00€ që ka një rritje prej 322,490.00€ krahasuar me totali e buxhetit të vitit të kaluar duke ju referuar qarkores së parë buxhetore 2023/01 ta kemi parasysh.
8. Për projeksionet e viteve 2025-2026 referojuni qarkores buxhetore 2024/01, dhe bëjeni parashikimin për KAB-in komunal sepse duhet të bëhet planifikimi për tri vite.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 01-180-4359
Nr. i faq. 3
Data 18/05/2023

Bashkangjitur:

A) Deklarata për misionin dhe performansën sipas Drejtorive/ Programeve
B) Qarkorja Buxhetore nr. 2024/01 për Komuna
C) Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025 – Të rishikohet Lista e projekteve 2023-2025 dhe propozimet për 2026 ti bashkangjiten listës në formularin A, nga ana e Drejtorive, në rast se keni projekte të reja që nuk janë pjesë e KAB-it 2023-2025.

**Vërejtje:**

Sqarime më të hollësishme rreth plotësimit të Kërkesave buxhetore- formularëve, mund të merren në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe nga Zyrtari Kryesor Financiar.

Bashkangjitur në ANEKS keni edhe tabelat për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor të cilat duhet të plotësohen në formularin A dhe të jenë pjesë e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026.

## ANEKS 1
## Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor

Tabela 1. Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore përkatëse
Emri i Institucionit/Ministrisë/Komunës

| Viti | Numri total i stafit | Numri total i stafit që janë gra | Numri total i stafit që janë burra | Paga dhe mëditje/Shuma për gra | Paga dhe mëditje/Shuma për burra |
|---|---|---|---|---|---|
| 2021 | | | | | |
| 2022 | | | | | |
| 2023 | | | | | |
| Planifikimi për 2024 | | | | | |

Tabela 2.Planifikimi për vitin 2023 Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore
Emri i Institucionit/Ministrisë/Komunës

| Niveli i pagave | Numri total i stafit në këtë nivel të pagave | Numri i burrave në këtë nivel | Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel | Numri i grave në këtë nivel. | Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel |
|---|---|---|---|---|---|
| 201-400 | | | | | |
| 401-600 | | | | | |
| 600+ | | | | | |

**Tabela 3. Numri i përfituesve të subvencioneve apo edhe të shërbimeve ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)**

[Emri i Institucionit/Ministrisë/Komunës: Emri i Shërbimit/Subvencionit].

| Viti | Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar | Numri total i përfituesve | Numri i përfitueseve gra | Numri i Përfitueseve burra | Buxheti për gra | Buxheti për burra |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2021 | | | | | | |
| 2022 | | | | | | |
| 2023 | | | | | | |
| Planifikimi për 2024 | | | | | | |

## ANEKSI 2

INDIKATORËT E PERFORMANCËS SË PROGRAMIT BUXHETOR

Organizata buxhetore: KOMUNA JUNIK

| 636 KOMUNA E JUNIKUT | | |
|---|---|---|
| **Objektivi 1** | **Treguesi bazë** | **Treguesi i synuar** |
| | | |
| **Aktivitetet:** | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| **Objektivi 2** | **Treguesi bazë** | **Treguesi i synuar** |
| | | |
| **Aktivitetet:** | | |
| | | |
| | | |
| | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

| | |
|---|---|
| REFERENC-Ë: | Numër: 04-02/23 |
| PËR/ZA/TO: | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik |
| NGA/OD/FROM | Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A | 28.04.2023 |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

## PROCESVERBAL:

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së katër (4) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 28.04.2023, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit me pas konstatoi se mbledhje marin pjese te 13 antaret e kuvendit. Në mbledhje nga drejtoret prezent ishin: znj.Leunora Shehu-AD, znj.Vjollca Qestaj-DBF, znj. Gentiana Tofaj-DZHE, z. Xhavit Velijaj DAKRS, z. Fatos Shala-DSHMS dhe z. Demokrat Ganijaj-DSHPMSI

Anëtarët prezent

1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK
5. Ermelinda Llolluni - Anëtare, LDK
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Llolluni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK
10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. **Festina Maloku - Anëtare, AAK (Mungon)**
13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV
14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV
15. **Xhemë Tofaj-Anëtar LVV (Mungon)**

**Rendi i ditës i paraparë**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Informatë mbi Raportin periodik financiarë për Buxhetin dhe shpenzimet për periudhën Janar-Mars 2023,
3. Rishqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale për vitin 2023 sipas rekomandimeve të Ministrisë,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullore Edukativo-Arsimore (leximi i dytë),
5. Informatë mbi zhvillimin e sektorit të turizmit në Komune e Junikut, interesimi i bletarëve, buqëve dhe fermerëve për të aplikuar për Subvencione, punim i kanaleve të ujitjes së tokës bujqësore për këtë vit (rrjeti ka është paraparë të shtrihet- ndërtimi i kanaleve te reja),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozime vendimit të nismës së binjakëzimit te Komunës së Junikut me “The City of Niagara Falls-Canada”, “Halifax regional municipality-Canada” dhe “Calgary Municipalyity- Canada”, dhe
7. Të ndryshme.

z.Sadri Krasniqi, përshëndetje për te gjithë, unë nuk pata diçka rreth rendit te ditës, por rreth vonesës se materialit për ketë mbledhje, kisha sugjeruar qe herëve tjera kjo mos te ndodhë më, dhe materiali te sillet me kohë.

z.Shpejtim Gacaferi, ne mbledhjen e KPF_se e kemi pasur te paraparë ta mbajmë me 21.04.2023 e qe atë ditë ka qenë festë “Dita e Bajramit” dhe na është dashur ta mbajmë me datën 20.04.2023 dhe kemi patur disa ndryshime mes asaj qe kemi pasur ne mbledhjen e KPF_se dhe ndryshimet qe janë kërkuar nga kjo mbledhje e KPF_se, dhe deri sa u bene këto ndryshime, kjo është arsye e vonesës përndryshe e kemi parasysh dhe besoj se ne te ardhmen nuk do te ketë vonesa për material. Nëse dikush nuk ka diçka rreth rendit te ditës unë e hedhi ne votim e ketë rend te ditës kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rendi i ditës i paraparë për mbledhjen e sotit u miratua.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Zenel Maloku, përshëndetje për te gjithë, sa i përket këtij procesverbali unë kam vërejtur disa gabime siç është këtu ne faqe 5 ku thuhet ”është paraparë te shtrihet nderimi” mendoj se kjo te shikohet edhe një here dhe te përmirësohet dhe ne te ardhmen te ketë kujdes me këto gabime.

z.Shpejtim Gacaferi, edhe për procesverbalin kemi qenë te detyruar ta sjellim sa ma shpejt për arsye te festes dhe e kemi sjellur te pa lektoruar, ka edhe gabime tjera siç është fjala te z.Leonard Llolluni ne faqe 3 ku thuhet për shumën 90100€ dhe duhet te jete 19100€, por si do qoftë me lektorimin e këtij procesverbalit besoj se do te përmirësohen edhe këto gabime. Nëse nuk ka dikush tjetër diçka me shtuar unë e hedhi ne votim, kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota, dhe abstenime 0 vota, konstatoi se procesverbali i mbledhjes se kaluar me këto vërejtje u miratua.

2. Informatë mbi Raportin periodik financiarë për Buxhetin dhe shpenzimet për periudhën Janar-Mars 2023,

Rportin periodik financiar për buxhetin dhe shpenzimet për periudhën Janar-Mars 2023 e beri znj.Vjollca Qestaj drejtoreshe ne DBF, e cila fillimisht i përshëndeti te gjithë te pranishmit me pas e sqaroi dhe e arsyetoje para anëtarëve te kuvendit raportin financiar Janar-Mars 2023.

z.Leonard Llolluni, përshëndetje për te gjithë, sa i përket raportit te shpenzimeve ne faqe 9, te përfaqësimi i avokaturës per 3 muaj 1398€, çka ka përfaqësuar ky avokat Komunën me ketë vlerë kaq te lartë për tre muaj? Te shpenzimet e telefonisë zyra e Kryetari 307€ për tre muaj, ndërsa drekat zyrtare për tre muaj ne total kemi 1575€, por me se shumti po me intereson kjo shuma e avokatit.

znj.Vjollca Qestaj, te dreka zyrtare edhe pse i kemi prezantuar si shpenzime për ketë periudhë, këto janë obligime te viti te kaluar, ndërsa sa i përket shpenzimeve për avokat fjalën ja kaloj drejtoreshës se Administratës znj.Leonora Shehu.

znj. Leonora Shehu, përshëndetje për te gjithë, sa i përket shpenzimeve te përfaqësimit apo te avokaturës, Komuna e Junikut ne Korrik te vitit 2022 e ka nënshkruar një kontratë me operatorin ekonomik qe tashti e përfaqëson komunën e Junikut, ku ka një pagë mujore prej 699€ qe ka për detyrë ti mbroj interesat e Komunës se Junikut ne te gjitha instancat.

z.Leonard Llolluni, pagë mujore, a keni raport se çka na përfaqëson.

znj.Leonora Shehu për çdo muaj kemi menaxherin e kontratës qe benë raport për punën qe ka kryer dhe ne bazë te këtij raporti bahen pagesat.

z. Arten Hamza, përshëndetje për te gjithë, sa i përket përfaqësimit, siç e ceki edhe drejtoresha është kontrata me ketë operator ekonomik qe na përfaqëson ne instanca si procese gjygjësore qofshin ato edhe përmbaruesore, disa për përfaqësimin janë kërkesat qe vinë nga punëtorët arsimorë qe kanë te bëjnë me kontratën kolektive, pastaj çdo lëndë qe iniciohet në gjykatë, dhe ne bazë te raportit për çdo muaj bëhet edhe pagesa, nëse në ndonjë muaj nuk ka ndonjë procedurë atëherë nuk paguhet, por nëse në një muaj kryen vetëm një instancë apo më shumë ta zëmë 15 instanca, atëherë paguhet siç është ne kontratë 699€.

z.Leonard Llolluni, sa e gjatë është kjo kontratë?

z.Arten Hamza, kontrata është tri vjeçare.

z.Zenel Maloku, pse mos me u paguar avokati me seancë, 30€ ditën nëse kemi nevojë te na përfaqëson 3 herë ne muaj i bije se me 100€ e kryejmë një muaj, ndërsa ky vetëm një seancë paska pagë 699€, dhe a bane me dite se kush është ky avokat.

z.Arten Hamza, avokati është z.Naim Spahiu.

z.Lulzim Gacaferi, përshëndetje për te gjithë, çështja ka të bëjë me progresin e  shpenzimet kapitale  sipas projekteve për vitin 2023, ju e keni cekur këtu për blerjen e një automjeti ne shumën prej 20.000€, unë kërkojë nga ju a e keni paraparë qe ketë shumë ta mbuloni me shitjen e automjeteve qe i kemi apo si e keni paraparë, tjetra është cekur këtu bashkëfinancimi i projekteve te kanalizimeve te ujitjes “topilla ne Gaxherr”, rehabilitimi i rrugëve lokale, hapja e rrugëve fushore lokacioni “Troje Gjocaj” dhe etj, çka mua me beri përshtypje negative këtu, është e cekur  hapja e disa rrugëve qe nuk i frekuenton askush, por edhe ashtu si nuk e patë te arsyeshme qendrën e Junikut, ju e dini se ne kemi një projekt te përbashkët gjatë fushatës zgjedhore ku qytetareve te Junikut ju kemi ofruar atë projekt qe me ardhjen tonë ne pushtet ta ndërtojmë “qendrën” e Junikut dhe ne ketë raport qe ju po e prezantoni nuk po e shohë se është diku ky projekt, po shohë këtu se keni furnizimin me gjenerator objektin e komunës se Junikut ne shumë prej 15000€, a janë vendosur panelet solare mbi çatinë e objektit te komunës, qe lidhet me retiçencën, ketë shpenzim prej 15000€ për gjeneratorë po e shoh jashtë logjikës se shëndoshë, ndriçimi publik përgjatë shtratit te lumit “Erenik” është paraparë ne shumë prej 20.000€, projekti për kanalizim Te ujitjes, drejtorë te nderuar qe shumica prej juve nuk keni qenë në garë zgjedhore, dhe nuk e bartini mbi supet e juve atë qe ne ju kemi premtuar qytetarëve te Junikut por ne ju kemi premtuar qe ata do ta kenë me te lehte ujitjen e tokave bujqësore ju kemi premtuar se do te kanalizojmë te gjitha kanalet e ujitës, dhe ju si drejtorë e keni për obligim qe te komunikoni me ne se cilat janë prioritete për ne  qytetaret, ju  keni ardhur këtu bllanko por e keni për obligim qe te komunikoni për prioritete me ne si përfaqësues te popullit. Projektin për qendër te Junikut e kemi edhe ne kontratë qe e kemi për marrëveshje me kryetarin e Junikut z.Ruzhdi Shehu, dhe kemi marrëveshje qe ky projekt te implementohet nga a deri ne zh a ju as qe e keni shti ketu, ky është një mashtrim i qytetarëve te Junikut.

z.Leonard Llolluni, kur është votuar buxheti për ketë vite, kryetari i komunës e ka shti ne buxhet projektimi e projektit qendra e junikut per kete vit, a ne sot ne ketë raport nuk e shohim qe ka filluar diçka ne kete drejtim.

z.Arten Hamza, unë po përgjigjem vetëm për çështje teknike, po e sqaroj çështjen e projekteve kapitale, siq e shihni për periudhën janar-mars 2023 nuk ka shpenzime te projektet kapitale, vetem eshte gjendja e paraqitur sipas ligjeve te buxhetit, projekte e aprovuara dhe alokimi i mjeteve deri ne ketë faze, te gjitha këto projekte janë te buxhetuara me buxhet te komunës, nuk ka financimet te ministrive apo te organizatave te tjera dhe këto projekte janë qe rrjedhin nga kroniza afatmesme buxhetore dhe nga aprovimi i buxhetit për vitin 2023 qe është aprovuar ne shtatore te vitit 2022, te gjitha këto projekte mjete i kanë te siguruara vetëm presim qe ti fillojnë proceduara e prokurimit qe për projektin për automjetin për nevojat e komunës vetëm ka filluar proceduar e prokurimit, ndërsa sa i përket projektit qendra e Junikut ne muajin marse kemi bartur mjete e viti 2022 te pa shpenzuara për ketë projekt dhe ato parashihen qe ne ketë vite te kemi një projekt e qe shuma është 30.000€.

z.Leonard Llolluni, një pyetje për drejtoreshën e Buxhetit, ngritja e përformancës a është për ty projekt kapital, blerja e automjetit për nevoja te komunës a është projekt kapital, përmirësim ne qasje, kujdesi gjatë fëmijërisë a është projekt kapital. Po ashtu kërkojë që në seancën e radhës se Kuvendit te na i sillni faturat për dreka zyrtare qe janë te paraqitura ne ketë raport, sepse e ka bërë si retorikë se jo janë te vitit te kaluar.

z.Arten Hamza, sa i përket projekteve qe i përmendi z.Leonard Llolluni, përmirësimi i qasjeve dhe përkujdesje gjatë fëmijërisë këto janë donacione që figurojnë tek investimet kapitale por nuk janë projekte kapitale.

z.Besart Tofaj, përshëndetje për te gjithë unë pata disa sqarime sa i përket blerjes automjeti te ri për nevoja te komunës është për shkak se tenderi për mirëmbajtje te automjeteve ka dështuar qe s`di sa here për shkak se nuk kemi pasur ofertues ku do te përfshiheshin mirëmbajtja e automjeteve te komunës te zjarrfikëseve dhe te QKMF_se, ndërsa sa i përket kanalizimeve te ujitjes, ne si komune kemi nje marrëveshje bashkëfinancimi me ministrin dhe na është kërkuar qe te specifikojmë se ne cilat lokacione do te ndërtohen këto kanale dhe kjo tash me është ne proceduar te tenderimit, rehabilitimi i rrugëve lokale ne qytetin e Junikut edhe ky projekt është ne fazen e tenderimit, hapja e rrugëve fushore lokacioni “Troje” dhe “Gjocaj” është projekt ne proces te pergaditjes, rregullimi i rrugës “Bajraktar-Gaxherr” vetëm është nënshkruar kontrata, janë edhe tri projekte shtese por qe ende nuk është mare konfirmimi nga ministria siç është projekti kanalizimi i ujrave te zeza ne “Moronicë” dhe “Krasniq” ne shume prej 55000€ si dhe muri mbrojtës ne “Tofaj” dhe “Pepsh” ne shume prej 20000€ dhe Operatori ne QKMF ne shumë prej 5000€, ndërsa sa i përket kanaleve te ujitjes qe i kemi premtuar ne ato i kemi adresuar dhe ato i ke ne piken e 5 te këtij raporti.

z.Lulzim Gacaferi, faleminderit nënkryetar për këto informacione, ju e keni parapare këtë blerjen e veture për nevoja te Komunës, a mund te ma thuani se për cilin sektor e keni paraparë apo për cilën drejtori, tjetra ju e dini nënkryetar dhe ju drejtor i shëndetësisë se ne QKMF ekziston një aparaturë për röntgen qe ka ardhur para disa viteve dhe sot e asaj dite nuk është funksionalizuar dhe do ishte me mire dhe me arsyeshme qe te ndani një shume prej 20.000€ për ngritjen e kuadrit qe do te shërbente me atë aparaturë dhe jo për automjete sepse komuna e Junikut ka 10 vetura dhe shumë shpesh shohë zyrtarë qe enden poshtë e përpjetë e nuk di a i kontrollon ndonjë kush, ndërsa sa i përket sqarimeve te z.Arten Hamza, ne e dimë se ky ka qen edhe avokat i pushtetit te më parshëm dhe tash është bërë edhe avokat i pushteti tonë dhe ne funde është vetëm një punëtorë dhe mos na sillni këtu zyrtar te pa disiplinuar dhe mos na detyroni te mbledhim nënshkrime qe këta persona mos te vinë ne seanca te kuvendit.

z.Zenel Maloku, unë desha te ndërlidhem me gjeneratorin për objektin e komunës, nëse ka mundësi qe te na sillni faturën.

znj.Leonora Shehu, edhe ne seancën e kaluar e kemi pasur ketë çështje dhe e kemi arsyetuar kur te fillojnë procedurat do ti keni edhe faturën edhe te gjithat çka është e nevojshme ti keni, për momentin ende nuk kanë flluar proceduarat sepse ende nuk janë bartur 5000€ qe i kemi kërkuar si shtese dhe ne momentin qe barten fillojnë proceduarat për te gjithat informacionet do te jeni te informuar.

z.Dervish Bajraktari, përshëndetje për te gjithë, po shihet se po bini ne kundërshtim me vetveten ketë nuk mundem me ju mohar, dhe se e bëni kamuflazhë këtu te ne dhe te qytetarët jeni te parët, po mashtroni me fatura janë te viti te kaluar, jo sot kemi me shumë kjo është e juaja dhe ne jemi mësuar me këto qe një vit e gjysmë, për projektimin e qendrës para se te votohet buxheti këtu herën e pare nuk ka kaluar sepse kemi thënë qe te futet edhe projektimi i qendrës pre vitin 2023

dhe mbasi është futur si projekt për vitin 2023 buxheti për herën e dyte është votuar, dhënë te gjithë e dimë se si projekti për vitin 2023 ka hyre projekti ndërtimi i qendrës se Junikut.

z.Zenun Shala, përshëndetje për te gjithë, ne takimin e fundit ka qene për bartjen e mjeteve nga viti 2022 ne vitin 2023 dhe aty janë bartur këto mjete ne drejtorin e urbanizimit 55000€ janë për projektin e kanalizimit te ujërave te zeza ne “Moronicë” dhe “Krasniq”, 20.000€ ndërtimi i mureve mbrojtëse ne “Tofaj” dhe “Pepsh” dhe 30690€ mallra dhe shërbime ku 8800€ padisje teknologjike pagesa per projekte gjeodezike 2310€ dhe 20000€ është hartimi i projekti ideor për qendren e Junikut.

z.Shpejtim Gacaferi, çështje tjetër nuk ka, kalojmë ne piken tjetër te radhës.

3. Rishqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale për vitin 2023 sipas rekomandimeve të Ministrisë,

Sqarimi dhe arsyetimine projekt-rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale para anëtareve te kuvendit e beri znj.Vjollca Qestaj drejtoreshë ne DBF.

z.Sadri Kraniqi, ne si grup i LDK_se i përkrahim këto ndryshimet e propozuara.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka para se te votojmë konstatoi se ne sallë prezent janë 11 anëtarët e kuvendit kush është për? për 10 vota, kundër 1 votë dhe abstenim 0 votë konstatoi se projekt rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale u miratua.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullore Edukativo-Arsimore (leximin i dytë),

Sqarimin dhe arsyetimin beri z.Xhavit Velijaj, drejtor i DAKRS i cili fillimisht i përshëndeti te gjithe me pas e sqaroi dhe e arsyetoj para anëtarëve te kuvendit projekt-rregulloren edukativo-arsimore.

znj.Rajmonda Krasniqi, përshëndetje për te gjithë, vetëm desha te shtoje te gjitha ndryshime nga leximi i pare ne lexim te dytë i keni ne tabelën e faqes se fundit vetëm ketë desha ta ceki.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkese tjetër nuk ka e konstatoi se ne sallë prezent janë 11 anëtarët e kuvendit, kush është për? për 11 vota, kundër 0 votë, abstenim 0 votë, konstatoi se projekt-rregullorja edukativo-arsimore u miratua.

5. Informatë mbi zhvillimin e sektorit të turizmit në Komunën e Junikut, interesimi i bletarëve, buqëve dhe fermerëve për të aplikuar për Subvencione, punim i kanaleve të ujitjes së tokës bujqësore për këtë vit (rrjeti ka është paraparë të shtrihet- ndërtimi i kanaleve te reja),

Informatën e beri znj.Gentiana Tofaj drejtoreshë ne DZHE, e cila fillimisht i përshëndeti te gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoi para anëtarëve te kuvendit informatën mbi zhvillimin e sektorit te

turizmit ne komunën e Junikut, interesimi i bletarëve, bujqëve, dhe fermerëve për të aplikuar për Subvencione, punim i kanaleve të ujitjes së tokës bujqësore për këtë vit (rrjeti ka është paraparë të shtrihet- ndërtimi i kanaleve te reja),

z.Lulzim Gacaferi, a i keni identifikuar pronat se ku kanë ma prioritet për ujitje? Unë mendoj se pronat bujqësore qe ne ju kemi premtuar se do t'ju sjellim kanalizimin e ujitjes është përafërsisht 50 hektar dhe unë mendoj se kjo pjese duhet te jetë edhe për ju prioritet qe kanalizimi te ndërtohet ne ata pjesë, unë nuk jam kundër për ata qe ju do ti ndërtoni kanalizime por jam udhëtar qe se pari te shikohen mundësit për ata qe juve ju kanë sjellë këtu jo ti anashkaloni por është mese primare qe ai kanalizim te shkoje deri ne fund tek toka e z.Bajram Gacaferit e qe janë mbi 50 hektar tokë bujqësore qe janë te varura nga ai kanalizimi i ujitjes.

z.Leonard Llolluni, faleminderit drejtoresh për këto informata, unë kam një pyetje, projekti italian "Natur-Kosovo", jam ne dijeni se te tri komuna kanë te drejtë te fitojnë një donacion prej 40.000€, dhe unë desha te di se komuna e Junikut me cilin projekt ka aplikuar ne ketë program?

znj.Gentiana Tofaj, ne si komune kemi ne plan qe ne ketë program "Natur-Kosovo" te aplikojmë me projekti qendra për informim te turizmit ku mendoje te ndërtojmë një qendër te informimit te turizmit ose këtu ne oborrin e komunës ose tek objekti i Shkollës Fillore "Edmond Hoxha".

znj.Eliza Pepshi, përshëndetje për te gjithë, ne mbledhjen e Komitetit për Komunitete kemi pasur nje takim dhe aty eshte folur pikërisht për kanalet e ujitjes dhe aty kam parashtruar kërkesë qe kanalit nga shtëpia e z.Rasim Pepshit e deri te fundi i lagjes "Pepsh" ka nevojë ekstreme për intervenim, dhe po shoh se nuk e keni shti ne këtë projekt dhe as nuk keni intervenuar asgjë deri sot, kisha dashur një përgjigje.

z.Zenun Shala, atë kanal e kemi futur ne këto kanale qe i folëm me herët te projekti për muret mbrojtëse "Tofaj" dhe "Pepsh".

z.Dervish Bajraktari, unë e kam pyetur edhe ne mbledhjen e KPF_së drejtoreshën, për kanalizimet e ujitjes ne lagjen "Bajraktar" a është marë si kërkesë ajo apo duhet prap te bëjmë kërkesë, fjala është për kanalin qe është nga shtëpia e z.Sadat Bajraktari.

znj.Gentiana Tofaj, fillimisht kërkesat qe i keni tash e tutje ti paraqitni edhe me shkrime me për arsye se edhe ne e kemi me te lete ti mbajmë, sepse ne kemi mbajtur edhe dëgjime publike dhe nga aty kan dalur edhe kerkesa tjera kshtu qe kërkesat do ishin mire te parashtrohen edhe me shkrim, ndersa sa i perkete ati kanali per kete vit nuk parashihet por ne do te bëjmë kërkesë ne ministrin e bujqesis prape qe te na mbështesin por mbetet te shihet a do te na mbështesin ketë vit apo ne vitin tjetër.

z.Zenel Maloku, nje pjese e fshatit Gjocaj dhe një pjese e madhe e fshatit Jasiq, kane nevoje te madhe per nje kanalizim te ujitjes, behet fjale për 150m me shume jo, kanalizimi për momentin eshte i zene nga shembja e rruges, behet fjale për pronat nga siç e quajmë ne "Mullini i Sylës" do ishte mire qe ta keni prioritet edhe ketë kanal.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese tjeter nuk ka , kalojmë ne piken e radhës.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozime vendimit të nismës së binjakëzimit te Komunës së Junikut me The City of Niagara Falls-Canada, Halifax regional municipality-Canada dhe Calgary Municipalyity- Canada

z.Leonard Llolluni, kjo kërkesë na ka ardhur sot dhe ne nuk kemi kurrfarë materiali.

z.Shpejtim Gacaferi, unë e kame kërkesën dhe për derisa te përgatitet materiali kërkoj nga ju një pauzë prej 10 minuta.

Pas Puze

z.Shejtim Gacaferi, materialin tash me e keni, arsyetimin e keni si dhe ne cilat fusha do te ketë bashkëpunim e keni.

z.Sadri Krasniqi, ne grupi i LDK_se e përkrahim ketë kërkesë mendoj se është ne interes te Komunës tonë qe te ketë binjakëzim me këto komuna.

z.Leonard Llolluni, me qe tash me e kemi materialin dhe kemi informacionin e duhur edhe ne si grup i AAK_se e përkrahim ketë kërkesë.

z.Lulzim Gacaferi, edhe ne si grup i LVV_je e përkrahim ketë kërkesë për binjakëzim me këto komuna dhe i përgëzojë ata  qe e kanë mare ketë iniciativë.

z.Shpejtim Gacaferi, me qense kërkesa dhe qëllimi është i njëjti për te tri komuna qe do te binjakëzohet unë kërkoj qe ti qes ne votim te gjitha me një here nëse edhe ju jeni te dakortit, para votimit e konstatoi se prezent ne sallë janë 11 anëtarët e kuvendit kormunal , kush është për që të votohen te tri komuna me një votim? për 11 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 0 vota, tash votojmë për binjakëzimin me tri komuna e lartpërmendura, kush është për? për 11 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota konstatoi se kërkesa për binjakëzimin e Komunës se Junikut me tri Komunat e lartcekura u miratua.

7. Te ndryshme

z.Lulzim Gacaferi, meqë e kemi prezent drejtorin e arsimit z.Xhavit Velijaj, kam një pyetje per te, kur e keni paraparë qe në shkollat tona të ketë një psikolog? Pasi që është shumë e nevojshme që ta kemi në shkolla një psikolog, me sa e di qe nga paslufta e deri sot nuk ka pasur psikolog, ndërsa pyetja tjetër është lidhur me sekretarin e shkollës, a e keni paraparë qe sekretarin e shkollës ta zgjidhni me profesion Jurist? pyetja tjetër është për drejtorin e shëndetësisë z.Fatos Shala, kur e keni paraparë që QKMF_ja te jetë funksionale 24 orë, si dhe aparatura e rëntgenit kur do te jetë funksionale? Dhe çështja tjetër ka të bejë me lagjen “Agim Ramadani” që ka nevojë që të furnizohet me ujin që ne e përdorim për pije,  ne ju kemi premtuar atyre që me ardhjen tonë në pushtet, do te ju sjellim edhe atyre ujin e pijes nga burimet ku furnizohet ter pjesa tjetër e Junikut, por ky premtim deri sot ende nuk eshte kryer, meqense qeverisja e kaluar lokale ka bërë një pjesë të punës, kur do ta përfundoni ketë çështje që lagjja “Agim Ramadani”te ketë ujin e Junikut për pije?

z.Xhavit Velijaj, përshëndetje për të gjithë, faleminderit në pyetje, ne e kemi diskutuar që edhe shkollat tona ne komunën e Junikut te kenë psikolog, për arsye se ka raste që duhen te trajtohen, mirë por për shkak të kritereve që janë, e që në bazë të numrit të nxënësve qe ne kemi nuk është paraparë që të kemi psikolog, përkundër kësaj ne jemi ka shikojmë mundësitë që ti kombinojmë shkollat dhe ta bëjmë një kërkesë që ne nivel te komunës ta kemi një psikolog, ndërsa sa i përket sekretarit te shkollës ne jemi në proces te regrutimit, është paraparë të jetë jurist mirëpo nuk është kriter që të zgjidhet vetëm jurist.

z.Fatos Shala, përshendetje për të gjithë, faleminderit për pyetje, e para do kisha dëshirë që kjo pyetje të mos më shtrohet me asnjë here dhe qe kjo te realizohet, para disa muajve kemi hapur konkurs për një radiolog mirëpo nuk kemi pasur sukses nuk është paraqitur asnjë kandidat, për derisa se nuk është realizuar kjo deri tani, ka të bëjë se nuk na kanë mbështetur në rritjen e stafit e qe jemi mbetur në 33, tani jemi ka shiqojmë mundesitë që me kontrata në shërbim ta rrisim stafin me staf shtesë që të kryhen shërbimet e 24 orshit e në kuadër të kësaj edhe për një radiolog që ne nuk do te heqim dorë, ketë e verteton se ne e kemi paraparë ketë shërbim edhe me taksa e ngarkesa që u prezentua sot ktu para juve, por edhe përkunder kësaj nuk mundemi të japim një përgjigje se kur do të ndodhë kjo, sepse ka të bejë me procedura. Ndërsa sa i përket aparaturës së rentgenit, unë në fillim te mandatit bashkë me nënkryetarin e kemi vizituar dhomën e rëntgenit dhe kemi vrejtur se aparatura e rentgenit shumicën e paisjeve e ka të paketuar që të jep me kuptuar se nuk eshtë hyrë në funksion asnjë herë. Do ishte mirë që të kërkojmë nga ata që na e kanë sjellur ta bëjnë funksionale dhe më pas me kontratë në shërbim do mund te kemi një person më adekuat që do mund ta kryente këtë shërbim.

z.Besmir Tofaj. Sa i përket ujit të pijes në lagjen “Agim Ramadani” në tetor te vitit të kaluar kemi marë zotimin nga ministri se do ta kryej edhe atë pjesë, pastaj ketë vit kemi qenë edhe me z.Lulzim Gacaferi ku e kemi takuar ministrin ku kemi marë garanti se do ta perfundojmë, ka qenë një hezitim i joni qe ata ujë mund të meret edhe nga komuna e Gjakovës, për ketë kemi hezituar pak, tashti ketë çeshtje e ka adresuar kompanija rajonale “Hidrodrini” që edhe kanë ndarë diku 85.000€ për ketë projekt, nuk e di a e perfshinë zgjerimin e kapaciteteve apo vetëm hapjen e kanaleve që me derguar ujin ne lagjen “Agim Ramadani” besoj se ka Qershori i këtij viti do te kemi një pasqyrë me të çartë se çka do të bejnë, sepse deri me tani nuk na është kërkuar një mendim nga ne, se çka do të bëhet.

z.Lulzim Gacaferi, nënkryetar i nderuar, ne bashkë kemi qenë te ministri z.Elbert Krasniqi, ne kërkuam nga ministri që ujin e pijes që ne e konsumojmë ne Junik ta sjellim ne lagjen “Agim Ramadani”, kërkuam qe te ndërtohen edhe dy bazena shtesë që qytetarët e Junikut mos te kenë mungesë të ujit, na është thenë që mbrenda një jave të sjellni dokumentacionin dhe do të ndahen mjetet finaciare per ujësjellsin për lagjen “Agim Ramadani” pse nuk e keni berë ketë?

z.Besart Tofaj, ju thash se kemi hezituar për shkak se ujin do e merrnin edhe fshatrat e komunës se Gjakovës.

z.Leonard Llolluni, te pika të ndryshme pata çështjen e njëjtë funksionalizimin e QKMF_së për 24 orë, që ishte premtim i kësaj qeverie dhe shkuan dy vite dhe besoj se do te shkojnë edhe dy vite tjera dhe nuk ka me ndodhë kjo. Ndërsa sa i përket asaj qe tha drejtori që do të mundohemi me kontrata në shërbim sepse nuk mundesh ti mbash me vite me kontratë në shërbim. por vetëm

për dy apo tre muaj, dhe sipas mendimit tim kjo nuk është serioze të thuhet kështu por edhe nuk do të ndodhë, edhe pse personalisht jam që QKMF_ja të funksionoj 24 orë por e kam ditur se kur është premtuar kjo nuk do të ndodhë.

z.Fatos Shala, ne jemi duke kërkuar mbështetje për staf të mesëm dhe kërkesa nga QKMF_ja është edhe për tre shoferë dhe katër infermier, stafi tjetër është por për ta funksionuar dhe që të shkoj pa problem na duhet te kemi personel me kontratë në shërbim për vitin e parë, e më pas e cakton edhe politika se si do të shkohet tutje, ne mundemi edhe tani t'ia fillojmë qe stafin aktual ta ngarkojmë me punë shtesë por kjo nuk na jep siguri që të vazhdoj.

z.Lulzim Gacaferi, pyetje për ty kryesues, kur do ta bëni zërimin e kësaj asambleje, na thuaj një ditë një muaj kur do te ndodhë që ne mos ta ngrisim zërin?

z.Shpejtim Gacaferi, unë edhe pse jam kryesues i kësaj asambleje nuk e di se kur do të ndodhë, salla e asamblesë i takon drejtorisë se Administratës dhe ata munden me u përgjigjur.

znj.Leonora Shehu, sa i përket zërimit të sallës së kuvendit, ne si drejtori kemi drejtuar një kërkesë për zërim të sallës në ministrinë e administratës lokale dhe ende nuk kemi një përgjigje, por edhe përkundër kësaj nëse nuk kemi një përgjigje nga MAPL, do te mundohemi ta përfshimë për vitin tjetër ne projektet kapitale.

znj.Rajmonda Krasniqi, pyetje për drejtorin e arsimit, pasi që ka kërkesa të shumta nga studentët, është thenë se shumë shpejt do te hapet konkursi për bursa, por deri tani ende nuk po ka diçka, dhe po dua te di se çka është duke ndodhur.

z.Dervish Bajraktari, edhe unë kam te njëjtin shqetësim, e kemi ngritur edhe në dhjetor ketë çështje, bursat studentore ka qenë edhe premtim zgjedhor nga ju por ne po shohim se deri tani nuk keni ndarë asnjë bursë jemi ne përfundim te viti kalendarik 2022-2023 dhe nuk ka bursa, çka është duke ndodhë a do të ketë bursa për studentët e komunës së Junikut a nuk do të ketë.

z.Xhavit Velijaj, faleminderit për pyetjen ne dhjetor te vitit të kaluar ne e kemi biseduar për ketë çështje dhe ju e dini se për vitin e kaluar nuk kemi ndarë bursa për shkak se kishim borxhe te vitit 2021, ndërsa për ketë vit do të hapet konkursi, mirëpo ne e kemi prolonguar për shkak se ne mos ta hapim tash përderisa është gjysma e vitit shkollor dhe kemi menduar që për shkak që procesi të jetë në rregull kjo duhet të hapet në Nëntor për shkak te përmbushjes se kriterit te regjistrimit te viti shkollor 2023-2024 dhe më pas vinë kriteret tjera siç është nota mesatare, kryetari gjithnjë ka insistuar qe te hapim konkurs për bursa por ka qenë kërkesë e imja që kjo të hapet në Nëntor për arsye qe te shkon ne binarë dhe në rregull kjo çështje.

z.Dervish Bajraktari, sa i përket kritereve do ishte mirë që kjo të hapet në ketë kohë pasi që janë provimet e Qershorit dhe çdo student do mundohej ta përmirësonte notën ose te merë notë me të mirë, edhe tjetra është se shumë komuna në Shkurt kanë hapur konkurs për bursa për studentet e ktyre komunave.

z.Zenel Maloku, unë kryesues kam kërkesë nga ju që drejtorët dhe zyrtarët qe marin pjesë në seancën e mbledhjes te rrinë deri në fund që të kemi mundësi të ju shtrojmë pyetje për çdo

çështje dhe jo te largohen, çështja tjetër ka të bëjë me aparaturën e röntgenit qe u fol sot këtu e që ende paska pajisjet te paketuara kjo më shqetëson, dhe kisha lutur drejtorin qe te gjejë ndonjë ekspert qe ta bëjë instalimin e tyre, ndërsa çështja tjetër ka të bëj me ujin e pijes në lagjen "Agim Ramadani" kjo çështje është ngritur si çështje edhe ne kuvendin e Republikës së Kosovës aq lartë është ngritur kjo çështje sa që përkundër asaj që keni berë be në fushatë zgjedhore, aq sa kam menduar qe do te ketë vërshime nga uji që do te na sillni aty a në fakt nuk është pika e ujit, e deri tani shpenzimi më i madh që është berë për ketë çështje është blerja e 20m gype qe metra kushton 0.50 cent qe i bije 10€ janë blerë dy kroje nga 7.50€ qe i bije 15€ gjithsejtë i bije ky shpenzim 25€ kjo është shuma qe keni shpenzuar si Komune.

z.Shpejtim Gacaferi, çështje tjetër nuk ka, e shpalli të mbyllur mbledhjen e Prillit 2023

| | |
|---|---|
| Procesmbajtësi: | Kryesuesi i Kuvendit: |
| z. Esat Hoxha | z. Shpejtim Gacaferi |
| _______________ | __________________ |